



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 175

Datë: 04.04.2022

PROCESVERBAL

i mbledhjes së dytë (II) urgjente të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND I DITËS

1. Rishqyrtimi i vendimit nr.02/04 datë: 10.01.2022, për miratimin e Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitet 2022-2024 me theks të veçantë për vitin 2022, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-20/1 datë: 17.01.2022.

Mbledhja u mbajt me datë: 31.01.2022 dhe filloi në ora: 10:15. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 30 asambleistë, kryetari, nënkryetari, drejtorë komunal, qytetarë nga komuna e Malishevës dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: I nderuar kryetar z.Ekrem Kastrati, të nderuar drejtorë, të nderuar asambleistë dhe gjithë ju të pranishëm në sallë përshëndetje për të gjithë!

Hapim mbledhjen e dytë urgjente të kuvendit komunal të Malishevës. Prezent në sallë janë 30 asambleistë. Në këtë mbledhje kemi vetëm një pikë të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit nr.02/04 datë: 10.01.2022, për miratimin e Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitet 2022-2024 me theks të veçantë për vitin 2022, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-20/1 datë: 17.01.2022.

Kush është për këtë rend të ditës?

Për: 27

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me 27 vota për, asnjë kundër dhe 3 abstenime, aprovohet rendi i ditës.

Për të paraqitur këtë projekt-buxhet, ftoj drejtorin për Buxhet dhe Financa z. Blerim Thaçi.

Blerim Thaçi: Përshëndejte kryetar Kastrati, të nderuar drejtorë dhe ju asambleistë!

Projekt-buxheti i paraqitur sot para jush është po ai buxhet që ka qenë më herët, me një ndryshim të vogël, duke pasur parasysh që në kërkesën e Ministries së Financave të çështja e hartimit të qenë I prezantuar si investim kapital në buxhet ndërsa është kërkuar nga Ministria që të kalojë në mallra dhe shërbime.. Gjithashtu mbjellja e drunjëve që ka qenë pjesë e investimeve kapitale dhe shënjestimi i rrugëve, me kërkesën e Ministries është kërkuar që këto investime të kalojnë në mallra dhe shërbime. Për çështjen e shifrave dhe statistikave që janë të prezantuar në projekt buxhet i keni dhe besoj që i keni shfletuar. Nëse ka ndonjë pyetje, ne do ju pergjigjemi. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Hapim debat. Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Sot jemi mbledhur për herë të dytë për të diskutuar dhe miratuar projekt buxhetin për vitin 2022-2024, me theks të veçantë për vitin 2022. Të nderuar kolegë, në cilësinë e antarit komunal të Malishevës, me datë: 06.01.2022 theksova që seanca e thirrur po në atë datë për miratimin e buxhetit për vitin 2022-2024 ishte shumë e ngutuar, sepse dhe materiali i asaj kohe na erdhi me vonesë. Gjatë asaj seance ne i dhamë vërejtjet dhe rekomandimet tona, meqenëse asaj kohe nuk kishim kohën dhe hapsirën për të shfletuar më në detaje materialin rreth pikës më të rëndësishme, projekt buxhetin 2022-2024 për komunën e Malishevës. Këtë kohë dhe hapsirë na mundësoj MAPL-ja, duke e konstatuar miratimin e projektbuxhetit të jashtëligjshëm. I përgëzoj të gjithë asambleistët që u treguan vigjilent dhe të guximshëm në lidhje me ankesën drejtuar Ministries. Meqenëse MAP-ja na ktheu si të jashtëligjshëm miratimin e buxhetit të datës:

06.01.2022, ne si antarë të këtij kuvendi në vazhdimësi kolegëve që ishin pjesë e legjislaturës së kaluar, na mundësoi të shohim më në brendësi edhe projektet të cilat as nuk u implementuan me kohë, por as nuk janë bartur fare dhe nuk figurojnë fare në vitin 2022-2024. Më lejoni t'i theksoj disa prej tyre: Parqet në Tërpezë të poshtme, në Astrazup, Carrallukë dhe Bardhë.

Kemi rrugë që nuk kanë përfunduar me kohë dhe janë larguar nga projekt buxheti, psh rruga "Selim Islami", "Sherif Berisha" së bashku me pjesë të trotuareve siç është pjesa e trotuarit në rrugën "Kalaja" në Bardhë 600 metra. Pra, ajo as nuk ka përfunduar në afatet ligjore dhe as nuk është bartur në projekt buxhetin për vitin 2022-2024. Urojmë zyrtarë të ndryshëm dhe kryetarin Kastrati mos të përfundojnë nëpër seanca gjyqësore, si tek rasti i palestrës sportive në Drenovc, ku ajo fare nuk egziston.

Sa i përket kërkesave dhe projekteve në të mirë të qytetarëve të komunës së Malishevës dhe unë si përfaqësues dhe zëri i tyre në kuvend kam disa kërkesa, ku kërkoj që të hudhen në votim dhe pres nga të gjithë antarët e tjerë pa dallime politike mbështetjen për kërkesat në fjalë:

1. Të përfshihen parqet të cilat nuk u implementuan me kohë në Tërpezë të poshtme, në Astrazup, në Carrallukë dhe në Bardhë;
2. Punimi i parkungut të shkollës "Emin Duraku";
3. Punimi i trotuarit në rrugën "Shaqir Paqarizi" në Dragobil;
4. Vendosija e rrethrotullimit tek kryqëzimi i rrugës "Ibrahim Mazreku" dhe rruga e "UÇK" kryqëzimi tek gjamia e fshatit në Dragobil;
5. Asfaltimi i rrugëve "Sherif Berisha" 200 metra, "Selim Islami" 100 metra, lagjia e Jadragjeve apo degëzimi i parë majtas në rrugën "Kalaja" Bardhë 250 metra;
6. Ndriqimi publik në rrugën "Ahmet Krasniqi" 10 trupa Bardhë.

Të nderuar antarë të kuvendit kërkoj nga secili nga ju si përfaqësues të drejtpërdrejtë të popullit të më mbështetëni të kjo kërkesë. Unë, Valon Krasniqi antarë i kuvendit komunal të Malishevës mbështetje unanime për të futur në projekt buxhetin 2022-2024 ndërtimin e lapidarit të dëshmorit të kombit "Afrim Krasniqi" në vlerë prej 25.000 euro. Specifikisht ndërtimi të bëhet në vendëllindjen e tij në Bardhë. Kjo kërkesë kërkoj që të hudhet në votim si e vetme ndërsa të tjerat në pako. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Fjalën e ka Nebih Bibaj.

Nebih Bibaj: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, të nderuar drejtor, kolegë asambleistë, përfaqësues të mediave dhe gjithë ju të pranishëm!

Sot me kërkesën e MAPL-së po kthehemi në rishqyrtim të projekt-buxhetit më theks të veçantë të vitit 2022. Kryetar, kur po themi që është mirë të na dëgjoni dhe neve si opozit, po e merrni pak si me shaka, mirëpo është mirë me i ndëgju të gjithë antarët e kuvendit, sepse dhe po na kthehen vendimet prej MAPL-së. Atë ditë e kemi cekur se nuk ka pasur ndonjë nguti të madhe që të shkojë buxheti në atë formë.

Drejtor, unë e kam dhe projekt buxhetin që e keni hartuar vitin e kaluar, mua më intereson për largimin e disa projekteve të cilat kanë ndodhur. Te rregullimi i kanalizimeve në qytetin e Malishevës dhe fshatra lagjia Krasniqi, Idrizaj, Fetahaj janë të larguara prej projektit.

Mirëmbajtja e rrugëve lokale, nuk e di a ka qenë me kontratë e kontraktume, apo ka përfunduar kontrata, kjo është e larguar. A po flasim për mirëmbajtje të rrugëve dimrore apo për mirëmbajtjen e rrugëve nga gropat dhe kjo është larguar. Shënjëzimi i rrugëve dhe objekteve publike në qytet dhe kjo është larguar. Ka qenë në projekt buxhetin e shtatorit, mirëpo tani në projekt buxhetin e ri nuk egziston.

Ndërtimi i rrugës “Jemin Mazreku” 400m në Malishevë është në këtë projekt buxhetin por nuk e di a është realizuar në teren, a është përfunduar kontrata.

Rregullimi i trotuarit në rrugën “Imer Krasniqi” në Kijevë dhe kjo është larguar. Ndërimi i infrastrukturës, kanalizim, ujësjellës, trotuar, ndriqim dhe asfaltim në rrugën “Ibrahim Mazreku” në Malishevë dhe kjo është larguar, nuk është në projekt buxhetin e ri. Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat e komunës së Malishevës dhe kjo pikë është larguar.

Do ndalem te një projekt që ka tri vite që hynë te E-kiosket, që kemi vendosur që një E-kiosk të vendoset në Kijevë dhe njëra në Malishevë. Unë mendoj që dhe atëherë kur e kemi bërë planifikimin e buxhetit, ka qenë një ndër projektet më të mira për nxjerrjen e dokumenteve për qytetarët, sidomos për pjesën që vjen nga Kijeva, ndërsa në projekt buxhetin e ri këto E-kioska nuk janë. Unë kisha pasur dëshirë që të mbesin dy E-kioska, njëra të vendoset në oborrin e komunës ose në ndonjë vend të përshtatshëm dhe tjetra të vendoset në qendrën e Kijevës. Ndërtimi i tribunes përcjellëse në verilindje të stadiumit të qytetit, ajo pjesë ende nuk është realizuar si projekt dhe është mbetur jashtëzakonisht keq, dy ditë punohet ndërsa tri jo. Drejtor, çka është bërë me atë kontratë, që ka ardhur në atë gjendje. Ne e dimë që mjetet janë ndarë për atë pjesë.

Në KPF-ë kemi bërë disa kërkesa, drejtor nuk e di a ke mundur t’i sjellësh.

Në Mleqan kanë qenë 700 m kanalizim dhe aty ka pasur nevojë vetëm për 300 ose 400 m kanalizim, ndërsa pjesa tjetër e kanalizimeve nuk e di ku ka shkuar. Çdo ndryshim i projekteve është mirë të vijë përsëri në kuvend. Unë nuk e pashë kërkesën që e kam bërë në KPF-ë, për projektet e realizuara në teren dhe borgjet ku munden me qenë.

Rrugën ku jetoj unë, 3 herë e futisim në projekt buxhet dhe asnjëherë nuk po gjen realizim.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar, kabinet qeveritar, kolegë asamblesitë dhe gjithë ju të pranishëm përshëndetje për të gjithë!

Është mirë ta dinë qytetarët e komunës së Malishevës, që vonesa e cila është krijuar në shërbimet e buxhetit, nuk është bërë me fajin e opozitës, por për shkak të kryenetsisë të pozitës. Të njejtat shqetësime i kemi paraqitur dhe në seancën e 6 Janarit, ku seanca është thirrur në mënyrë urgjente, duke na pamundësuar debatin në kuvend dhe propozimet tona.

Buxheti në total është 15,655,757.00 €. Ju e dini që buxheti ndahet në 5 kategori ekonomike dhe nëse e bëni për parallogaritje të thjeshtë kjo është struktura e buxhetit komunal të Malishevës, ku përfshinë paga dhe medijtje 8.591,643.00ose në total i bie 54.8% e buxhetit, mallra dhe shërbime është 1.729,729.99ose në përqindje 11.04%, shërbime komunale 455,000.00 në përqindje 2.93% dhe investime kapitale 4,379,384.00. Është një çështje shqetësuese që nëse e

bëjmë një parallogaritje të këtij buxheti, të investimet e bartura i keni nëpër kanalizime, trotuare, ujësjellëse. Rreth 60% e projekteve janë të bartura nga vitet e kaluara. Ky buxhet nuk i adreson premtimet të cilat janë dhënë, jo vetëm prej subjektit i cili është në pushtet, por dhe prej partive tjera politike nuk i adreson problemet më bazike të qytetarëve, çështja e ujësjellësit që është jetik për qytetarin e komunës së Malishevës dhe problemet me kanalizime.

Ju i keni pasur disa të dhëna buxhetore aty, që kryesisht kanë të bëjnë me kanalizime nëpër lagje, por jo ndonjë investim serioz kapital dhe me zgjidh problemin e kanalizimit. Është një pjesë Lubizhë-Bubël, që kanalizimet janë në gjendje shumë të keqe. Nuk adresohen problemet saktë të kanalizimeve. Çdo vendbanim i Malishevës ka probleme serioze me kanalizime.

Çështja e zbatimit të kontratës kolektive, për të cilën si zotim publik e kemi dhënë të gjitha subjektet politike në fushatë, nuk ishte i adresuar dhe është mirë me dhënë sqarim.

Në aspektin e shëndetësisë, na keni premtuar gjatë gjithë fushatës decentralizim të shërbimeve shëndetësore dhe përpos parashikimeve për blerjen e disa paisjeve, nuk kam parë ndonjë projekt serioz që shkon në drejtim të rritjes së kapaciteteve në shëndetësi. Në aspektin shëndetësorë jo vetëm tani që jemi në pandemi, por Malisheva është specifike sidomos gjatë sezonës së verës, kur ka probleme dhe me ethet hemoragjike, prandaj komuna është dashur të rrit kapacitetet në shëndetësi. Një shembull i mirë që është bërë në vitin 2014, e kemi qendrën e mjeksisë familjare në Kijevë, aty bëhet një punë e mirë, mirëpo ka mungesa të shumta. Ajo QMF-ë në vitin 2013-2014 kur ska qenë Nisma në pushtet me inicjativën time personale që e kam marrur dhe është realizuar në pushtet të Nismas, aty marrin shërbime mbi 20.000 qytetarë të atyre fshatrave, pa e marrur asnjë individ në punë, pa krijuar asnjë shpenzim shtesë.

Është mirë ta sjellini një listë të projekteve se cilat janë realizuar dhe çka pritet të realizohet. Unë e kam bërë një parallogaritje: Asfaltimi i rrugëve që i keni si kod buxhetor e përfshinë shumën 1.665.410 €. Pjesën më të madhe e merr kjo pjesa të ura në Malishevë, që shkon në drejtim të urës së tranzitit që është në vlerë 700.000 €, të tjerat janë rrugica.

Në total për trotuare janë të parapara 300.000 €, që besoj që janë të mjaftueshme, sepse ka mungesë të madhe. Rreth 600.000 € në total për të gjitha lagjet, vendbanimet janë të parapara për kanalizime. Në total të buxhetit për projekte të bartura që i kam llogaritur janë 2.534.910 € janë projekte të bartura, ndërsa projekte të reja nuk ka dhe kosto buxhetore të caktuar që ta dimë saktë në cilin vit fillon dhe kur përfundon. Janë 1.318.000 € projekte të reja që janë futur.

60% të buxhetit janë projekte të bartura. Ka shumë projekte të cilat në teren janë të realizuara dhe figuronë në vitin 2022. Prej vendbanimit nga vi, të lagjja Stapanic janë 700 m që lidhet me vien kryesore aty nuk e kanë zgjidh problem, mirëpo na ka krijuar problem shtesë, 2000 metra që vjen nga hotel Berisha, na kanë pamundësuar qasjen në pronat tona. Është e pamundur dhe e vështirë me jetu, sidomos lagja Toplana prej kundërmimit të ujërave të zeza. Drejtor, unë kisha kërkuar sqarim që duhen 3500 m kanalizim që lidhen me vien kryesore, që të paktën të largohet problemi që kanë banorët e Kijevës dhe Stapanicës me ujëra të zeza. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Faleminderit, Kryesues! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, drejtorë, të nderuar kolegë asambleistë!

Sot jemi duke e shqyrtuar dokumentin më bazik për vitin 2022, përmes të cilit paraqitet komplet aktiviteti i punës së qeveris. MAPL-ja e ka kthyer për shkak të procedurës dhe jo për diqka tjetër.

Ajo çka më bëri përshtypje në këtë buxhet është që janë disa politika të reja që janë integru në kuadër të buxhetit, sidomos në aspektin e subvensionimit në bujqësi, diku rreth 51.000 € janë ndarë për subvensionim të drejtpërdrejtë të qumshtit. Në bazë në kalkulimit 3cent për litër të qumshtit. Në kuadër të subvensioneve është subvensionimi ose shpërndarja e granteve për bizneset bujqësore. Këto ishin disa pikave të reja, që janë futur në kuadër të buxhetit.

Buxheti i komunës, kategorit ekonomike dhe totali buxhetor përcaktohet nga Ministria e Financave, përkatësisht përmes qarkores buxhetore. Ky buxhet në total është ndarë në tre programe kryesore: programin e arsimit, programin e administratës së përgjithshme dhe në programin e shëndetësisë. Përafërsisht diku prej 7.4 milion € janë të destinuara për arsim. Këto mjete janë të ndara në 5 kategori ekonomike, kryesisht në sektorin e arsimit kategoria e pagave dhe shtesave është njëra prej kategorive që merr me vete shumicën e buxhetit në pagat e këti grandit. Në shëndetësi janë të ndara sipas ligjit, sipas qarkores buxhetore. Grandi i arsimit dhe grandit i shëndetësisë janë grante specifike dhe janë 1.95 milion €, kurse 6.3 milion € janë për grandin e përgjithshëm. Të tria këto programe janë të ndara në 5 kategori ekonomike.

Te çështja e kontrates kolektive, në vitin 2021 komisioni i granteve për financimin e nivelit komunal ose buxhetimin e nivelit komunal i cili përbëhet nga Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Arsimit, i Financave dhe nga disa kryetar të disa komunave, kryetarët e komunave shkojnë me short. Shorti i ka rënë ish kryetarit Ragip Begaj, mirëpo për shkak të gjendjes shëndetësore nuk ka mundur të marr pjesë dhe më ka deleguar mua si ish drejtorë në atë kohë që të marrë pjesë në komisionin e granteve. Njëra prej kërkesave tona ka qenë buxhetimi i kontratave kolektive në arsim dhe në sektorët e tjerë, mirëpo kjo ka qenë e pamundur nga Ministria e Financave për faktin se ndikon në rritjen e kategorisë së pagave në nivel vendi dhe rritja e kategorisë së pagave nuk lejohet më tepër se sa rritja ekonomike brenda një viti fiskal në Kosovë. Obligimet e kontratës kolektive e kanë tejkaluar rritjen ose zhvillimin ekonomik të vendit, për këtë arsye nuk ka mundur me u buxhetu.

Rregullimi i rrugës "Ibrahim Mazreku" janë të ndara 309,869€. Rregullimi i trotuarit në rrugën "Imer Krasniqi" në fshatin Kijevë e keni të buxhetume. Te Administrata e keni blerjen e E-kioskave.

Labinot, për kanalizimet që janë të buxhetuara këtu, janë kontrata dy vjeçare. Je ekonomist, është programi i investimeve publike, ne i themi pip dhe aty regjistrohen projektet. Janë 250.000 € të ndara për kontratat dy vjeçare të kanalizimet, 290.000 € për trotualet dhe 700.000 € janë të ndara për rrugët dy vjeçare. Në çoftëse e krahasojmë me totalin e investimeve kapitale nuk është 60%. Uroj që ky projekt buxhet të implementohet ashtu siç është i buxhetum.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj : Arsyeja pse jemi në këtë seancë është sepse ka munguar një lloj bashkëpunimi prej pushtetit, gjatë të cilës e kemi kërkuar në gjatë seancës së 6 janari shtyrjen e asaj seance dhe që të përfillen të gjitha procedurat ligjore dhe kërkesat tona të futen në buxhet. Disa dilemma ligjore për të cilat kam kërkuar nga Muharremi që të sqarohen, sepse na është thirrur në një mbledhje urgjente të KPF-së, e cila ende nuk është themeluar me vendim të MAPL-së. Kemi pasur dhe një ankesë të një subjekti politik që ka kërkuar ligjshmëri të zgjedhjes së një antari prej

anës së LDK-së. Pa u sqaruar këto dy dilemma ne si KPF-ë do të kemi problem se a do të mundemi me rekomandu diqka për kuvend. Drejtor, të na sjellësh një raport që ne si asambleistë ta kemi të qartë se sa borgie i ka komuna, sa projekte janë realizuar dhe që figurojnë në projekt buxhet.

Kryetar, në këtë projekt buxhet nuk pashë ndonjë projekt madhor. Në planformën e juaj të fushatës, keni proglamu për Malishevën urbane dhe realisht në ato projekte nuk pashë një investim madhor. Në një debat publik që e kam pasur me profen, ka qenë zotim i juaji kryetar për ndërtimin e 5 çerdheve publike në Malishevë gjatë këtij mandati. Në vitin e parë nuk ka zero cent të ndara për ndërtimin e çerdheve. Është e planifikuar çerdhja në fshatin Bellanicë dhe realisht në vitin 2022 nuk është asnjë cent i planifikuar për ndërtimin e asaj çerdhe. I keni dy objekte të cilat me pak investim mundeni t'i bëni çerdhe publike. Është objekti i vjetër i shkollës fillore "Naim Frashëri" në Banjë. Është kërkesë e jona që të futet në buxhet rikonstruktimi i këtij objekti dhe të kthehet në çerdhe publike. Objekt tjetër është objekti i shkollës fillore në Dragobil.

Në projekt buxhet pashë investime në kanalizime nëpër fshatra. Ne të gjitha këto kanalizime po i sjellum prej fshatrave dhe po i derdhum në lumin Mirusha. Ndoshta ka qenë më mirë të ndahen mjete shtesë për ndërtimin e kolektorit kryesor. Të fillojmë investimin në këtë korrektorin kryesor, t'i largojnë ujërat e zeza prej lumit Mirusha, e pastaj investojmë në kanalizime nëpër fshatra.

Ne e dim që janë ndërtuar objekte shkollore. Kryetar, këtë investimin e qeverisjes komunale të paras tonë publike është mirë ta kthejmë në rritjen e cilësisë në arsim. Pra, mos ta shohim në arsimin vetëm mure dhe objekte. Ndane një fond prej 20.000 € ose 50.000 € e vlerësojmë këtu bashkë e shtyjmë përpara dhe furnizimin e bibliotekave të shkollave me libra shkollore.

Bibloteka e qytetit është e turpshme në çfarë gjendje është. Bibloteka e qytetit funksionon dy ose tre muaj në vit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Faleminderit, Kryesues!

Valon, po të drejtohem ty, unë as nuk shpika as nuk shpifa, ju referova shifrave ashtu siç i keni dhënë në buxhet. Rreth 590.000 € në bazë të shifrave janë të parapara për kanalizime, por fatkeqësisht janë dhe projekte të bartura. Rreth 279.500 € janë për trotuare, 915.000 € janë asfaltime të rrugicave nëpër fshatra dhe vendbanime të Malishevës, që pjesën më të madhe e merr pjesa tek ura.

Tek projektet 2 vjeçare nuk është mirë me na thy intelegjencën. Unë jetoj në Kijevë është projekt dy vjeçar, ato që është paraparë është përfunduar keq. Janë kryer në kohë fushate, dy ditë para zgjedhjeve, mirëpo na kanë krijuar probleme shtesë. Na kanë pamundësuar dhe qasjen në pronat tona, sidomos tek lagja Toplana via kryesore që shkon tek lagja Berisha, e kanë të pamundur jetën aty. Është mirë që aty ku i kemi problemet ekzistuese, me i zgjidhë e jo me krijuar probleme të reja. Pas një investimi prej Lubizhde në drejtim të Bublilit për kanalizime nuk pashë ndonjë shumë tjetër këtu. 57.8% janë investime të bartura.

Sa i përket fushës së arsimit, unë punoj që 22 vite në fushën e arsimit dhe si kemi punuar para lufte, punojmë dhe tani në drras të zezë me shkrumës. Shkollat po na zbrazen dhe duhet ta bëjmë

shkollën më atraktive për të rinjtë tonë dhe të bëjmë përpjekje që të ju lehtësojmë jetën këtyre qytetarëve, e sidomos moshës së re që janë e ardhmja .

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Rregullimi i rrugës “Ibrahim Mazreku” në Malishevë është e vërtetë që është në buxhet, vetëm desha ta specifikoj që në buxhetin e kaluar që e kemi bërë bashkë, ka qenë ndërtimi i infrastrukturës, kanalizimit, ujësjellësit, trotuarit, kanë qenë gjitha gjërat përcjellëse unë vetëm këtë e thash, nuk e thash që nuk është rregullimi i rrugës “Ibrahim Mazreku” por nuk e përfshinë këtë pjesën e infrastrukturës komplet.

Valon, ti e dinë që vetëm rrugët kanë qenë projekte dy vjeçare, projektet tjera kanë qenë projekte 1 vjeçare, por dhe ato që kanë qenë projekte një vjeçare nuk janë realizuar në teren.

Këto projekte që janë të bartura dhe po e dimë që janë duke u përsëritur disa here, është mirë të përfundojnë këtë vit, mos me qenë projekt prapë dy vjeçar. Ne të bëjmë projekte një vjeçare ato që mundemi me i kry dhe ato që nuk mundemi me i kry mos t'i bëjmë projekte dy vjeçare sepse po kemi probleme të vazhdueshme, që janë duke u përsëritur projektet dhe nuk po gjejnë zbatim në teren.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Unë nuk thash që po shif dikush, ose nuk i ka mbledhur të dhënat mirë. Secili e ka atë mënyren e vetë të kalkulimit dhe mbledhjen dhënave, dikujt mundet me i dalë saktë e dikujt mundet me i dalë gabim. Sa i përket rrugës “Ibrahim Mazreku” nëse keni informacion rrjeti i ujit është ndërru në atë rrugë. Rregullimi nuk e kufizon se çka ke me rregullu trotuar, kanalizim, ndriqim, mirëpo është rregullimi i rrugës dhe si koncept i fjalës në rregullim munden me u përfshi të gjitha rregullimet dhe nëntoksore dhe mbi toksore. Qytetarët e komunës së Malishevës ja kanë besuar programit të NISMA-s Socialdemokrate udhëheqjen dhe përcaktimin e projekteve dhe ajo çka është në dorën tonë urojm që komplet ky buxhet të implementohet ashtu siç e kanë planifikuar qeveria komunale, bashkë me propozimet që kanë dalur nga antarët e kuvendit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Faleminderit, Kryesues! Përsëndetje për ju asambleistë dhe ju drejtorë! Një vërejtje të vogël e kam për ju kryeses. Keni disa takime që i udhëheqni dhe së pari i drejtorëni i nderuar kryetar, të nderuar drejtorë dhe krejt në fund të nderuar asambleistë. Unë konsideroj që duhet të keni një konsideratë, asambleistët janë përfaqësues të qytetarëve, të zgjedhurit e popullit, ndërsa drejtorët janë të emruar.

Një kërkesë për Drejtorin e Financave, është mirë ta dimë se sa kemi borgje, që të jemi në dijeni dhe ne.

Drejtori i Shëndetësisë nuk qenka këtu. Unë para dy muajve kam qenë në Qendrën e Mjeksisë Familjare në Malishevë aty laboratorit për analiza është jashtë funksionit dhe më është dashur të shkoj t'i bëjë analizat privat. Ky defekt është dhe para dy dite pra, nuk është rregulluar ai

laborator. Për kuletën e qytetarit të Malishevës është një barrë e papërballueshme dhe kisha kërkuar dhe nga Drejtori i Shëndetësisë dhe nga Kryetari që të marrin masa urgjente dhe të rregullohet ky problem. Njëkohësisht e kisha përgëzuar dhe falenderuar Drejtorin e Shëndetësisë që një natë mbas orës 10 të natës ka qenë prezent në Qendrën e Mjeksisë Familjare duke i mobilizuar dhe duke vepruar në kordinim me mjekët kujdestar dhe mjek të tjerë. Drejtorët e tjerë ta marrin këtë shembull Drejtorin e Shëndetësisë dhe të jenë në krye të detyrës 24h, jo vetëm në orarin 8:00-16:00.

Kërkesë tjetër kam për Drejtorin për Gjeodezi dhe Kadastër. Unë vi nga Damaneku dhe si fshat kemi problem që zona kadastrale në si fshat na ndan në dysh, pjesa e lumit që vjen nga pjesa e Lubizhdes llogaritet gjysma e fshatit, gjysma e fshatit në si zonë kadastrale në kufijtë administrative llogariteti Lumisht, ndërsa pjesa tjetër Qypevë. D.m.th në hartë nuk figurojm pothuajse si fshat fare. Do ju drejtohem përmes kryetarit të fshatit dhe pastaj ju kisha kërkuar që të merrni hapa konkrete lidhur me këtë çështje.

Kam dhe disa kërkesa që i kemi përpiluar së bashku me kolegët e Partisë Demokratike të Kosovës. Si grup parlamentar i PDK-së kërkojm që të amandamentohen kërkesat në buxhetin e vitit 2022 dhe mendojm që këto projekte do të gjejnë zbatim tek organet kompetente.

Kërkesat tona janë këto:

1. Rruga që lidhë Shkozen me Rahovecin 2500m;
2. Ndërtimi i çerdhes në Drenoc, projekt 2 vjeçar;
3. Rrugë bujqësore në Mleqan 800m nga "Hoxhë Cena" deri tek rruga "Hoxhë Mustafa";
4. Trotuar 1 kilometer tek Vakafi në Vërmicë;
5. Ndriqimi publik në të gjitha fshatrat;
6. Vendosja e rrethrotullimit tek kryqëzimi në rrugën "Ibrahim Mazreku" që lidh rrugën e UÇK-së tek xhamia e fshatit Dragobil;
7. Punimi i parkingut të shkollës "Emin Duraku" në Dragobil;
8. Vazhdimi i asfaltimit të rrugës "Ali Paqarizi" në Dragobil me gjatësi 150 m;
9. Punimi i trotuarit në rrugën "Shaqir Paqarizi";
10. Pastrimi dhe rregullimi i hapsirës në pallanka në kryqëzimin e rrugëve që lidhë rrugët Burim, Gurbardh Astrazup dhe Dragobil;
11. Ndriqimi publik në lagjen "Balaj" 20 trupa Lladroc;
12. Trotuar në rrugën "Foleja e UÇK"-së 150m në Carrallukë;
13. Asfaltimi i rrugës "Faik Klonica" në Carrallukë 250m;
14. Pastrimi dhe rregullimi i lumit në mes të fshatit Damanek me gjatësi prej 800m,
15. Rregullimi i trotuarit në rrugën "Mësuesi Azem" në Damanek me gjatësi 400m,
16. Rregullimi dhe pastrimi i hapsirave gjelbruese rreth odës së Kastratëve ose më mirë të themi të krijohet një park,
17. Asfaltimi i rrugicave në rrugën "Sylejman Smajli" 100m, asfaltimi i rrugës "Rexhep Smajli" 90m dhe "Halil Hoti" 100m lagja e Kastratëve.
18. Asfaltimi i rrugës "Nebih Azemi" përkatësisht vëllezërve dhe veteranëve të UÇK-së Florim dhe Nazmi Krasniqi në Damanek. Këta banorë të kësaj rrugë kanë bërë kërkesë vazhdimisht që 8

vite, mirëpo vetëm pse nuk e mbështesin NISMA-n nuk është realizuar asnjëherë, ndërsa kryetari i fshatit që ka qenë dhe asambleistë nga radhët e NISMA-s, ai e ka shtrur rrugën e vetë në mandatin e parë, përveq kësaj rrugë që është shtruar dhe 150m kanalizim, asnjë investim tjetër në Damanek nuk është bërë. Kisha kërkuar që në këtë mandat të fokusoheni pak te fshati Damanek. Propozimet tjera janë: 19 Asfaltimi i rrugës “Naser Hysen Krasniqi” afër shkollës me gjatësi 200m;

20. Zgjerimi i rrugës në afërsi të nënkalimit në Mleqan në gjatësi 150m. Kam pas telefonatë prej banorëve të Mleqanit për një rrugë që është futur në projekt buxhet dhe më herët, por që nuk është implementuar rruga “Hidajet Kryeziu”, është një lagje e madhe dhe që disa vite nuk është shtruar asfalt. Është dhe një kërkesë e banorëve të Mleqanit tek nënkalimi që të bëhet një trase që qytetarët të dalin më lehtë në pronat e tyre për t’i punuar e jo të shkojnë në Kijevë dhe pastaj të kthehen prapë në pronat e tyre,

21. Asfaltimi i rrugës në Llapqev rrugës “Shtabi i UÇK”-së 900m.

22. Vazhdimi i kanalizimit 70m në Llapqevë,

23. Asfaltimi i rrugës “Edmond Hoxha” 200 m në Drenoc lagjja Jahaj,

24. Asfaltimi i rrugës “Sadik Jahaj” Drenoc,

25. Rregullimi i kanalizimit të prishur në lagjen “Hoxhaj” me gjatësi 50m në Marali,

26. Rregullimi i shtratit të hapur të kanalizimit rruga e “UÇK”-së me gjatësi 100m në Marali,

27. Asfaltimi i rrugës së Ulzave me gjatësi 250m në Marali,

28. Vendosja e rrethrotullimit të xhamia e fshatit në Marali,

29. Asfaltimi i rrugës “Kroi i Frashërit” me gjatësi 120m dhe degëzimi i parë majtas me gjatësi 50m në Marali,

30. Asfaltimi i rrugës “Meka” me gjatësi 250m në Marali,

31. Asfaltimi i rrugës “Luftëtari” me gjatësi 140m në Marali, asfaltimi i rrugës “Krenarët” 110m në Bubavec,

32. Trotuari prej shkollës deri tek lagjja e Idrizavitëve,

33. Kanalizimi në lagjen e Bashotëve dhe 4 rrugicave në lagjen e Dejlave në Bubavec.

Mbetemi me shpresë që këto projekte të propozuara të gjejnë zbatim. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëto, Veton!

Veton Zogaj: Ne si Vetëvendosje i kemi disa kërkesa të cilat janë:

1. Kthimi në çerdhe publike i dy objekteve shkolla e vjetër në Banjë dhe shkollës Emin Duraku në Dragobil. Kisha pasur dëshirë që çdo kërkesë të hudhet në votim veq e veq.

2. Rregullimi i ashensorit në QKMF dhe në objektin e komunës,

3. Funksionalizimin i repartit të gjinekologjisë,

4. Ndarja e një fondi prej 20.000 € për paisjen e bibliotekës së qytetit me libra dhe paisjen e bibliotekave nëpër shkolla,

5. Ndarja e 5.000 € për organizimin e panairit të librit në Malishevë.

6. Subvencionimi i patentë shoferëve për gratë, d.m.th të gjitha gratë që e marrin patentë shoferin të ju subvencionohen shërbimet që kryhen për patent shofer.

7. Vendosja e dy E-kioskeve, ky projekt është paraparë në vitin 2019-2020-2021. Njëra është e parapame në Malishevë ndërsa kishte me qenë mirë tjetrën me vendos në Kijevë, nuk është kosto e lartë. Njëren e keni parapar 14.000 € dhe vendosja e një E-kiosk në Kijevë bëjnë 28.000 euro.
 8. Vendosja e dy semaforve në rrugën kryesore “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, tek gjimnazi ku frekuentimi i nxënësve dhe i qytetarëve është shumë i madh dhe ka rrezikshmëri.
 9. Themelimi i muzeut të luftës dhe vendosja e muzeut tek objekti i veteranëve.
- Janë kërkesa të ndryshme dhe nuk është mirë që të votohen si pako.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Faleminderit, Kryesues! Ne si grup i LDK-së i kemi disa propozime për projekte të cilat janë:

1. Ndërtimi i objektit të ri të QMF-së në Kijevë, në vlerë 200.000 euro. Nëse ka vullnet politik ta bëjnë një gjë të tillë, mund të bëhet me bashkëpunim nëse arsytohet projekti me Ministrinë e Shëndetësisë, por mund të bëhet dhe me një memorandum bashkëpunimi me komunën e Klinës, për arsye se shumica e qytetarëve të asaj ane i marrin shërbimet në këtë qendër dhe objekti egzistues nuk i plotëson kushtet.

Ujësjellësi- Kijeva ka pasur ujësjellës në vitet 92-93 mirëpo ai ujësjellës është jashtë funksionit. Komuna e ka bërë shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit me ujësjellësin e Senikut. Kur është bërë ujësjellësi i Senikut ka qenë kapaciteti 30litra në sekond, ka qenë donacion mbi 1.000.000 i shtetit Zvicëran, ndërsa sot kapaciteti i tij është 2-3litra. Për këtë duhet të jep përgjegjësi dikush. Është premtuar dhe në fushat çështja e ujësjellësit të Panorcit dhe kjo nuk figuron askund dhe aty janë dhënë afro 1.000.000 € dhe banorët e Panorcit nuk kanë ujë.

2. Rrjeti i ujësjellësit në rrugën “Demush Gashi” 200 m dhe rruga “Riza Gashi” 400m;

4. Rruga “Tahir Hasanaj” me gjatësi 300m;

5. Rruga “Haxhi Gashi” deri tek rruga “Riza Gashi” në gjatësi 800m;

6. Rruga “Demush Gashi” me gjatësi 200m;

7. Rruga “Eqrem Qabej” në gjatësi 150m;

8. Rruga “Toplana” në gjatësi 150;

9. Rruga “Pa emër të kroi i fshatit” me gjatësi 150m;

Sipas kalkulimeve që i kam bërë në total kap shumën 20.125 €.

Kanalizimi: Problemi më jetik që e kanë banorët e Kijevës janë që ujërat e zeza të komunës së Klinës derdhen në territor të komunës së Malishevës, Kijevës sidomos tek kjo pjesa e Mleqanit që kanë dhe pusët e ujit të pijes dhe ujërat e zeza po paraqesin rrezik për këta banorë.

10. Propozimi është që të jetë kanalizim me gjatësi 3500m deri të lidhja me kanalizim kryesor .

11. Trotuari në rrugën kryesore “Imer Krasniqi” në gjatësi 3500m.

12. Rryma-Problemi më i madh që e kanë banorët e Kijevës e kanë dhe me rrymë, në disa lagje të fshatit shtyllat elektrike dhe rrjeti elektrik janë të viteve 70-ta. Shumica e familjeve përdorin zmadhues të energjisë elektrike përndryshe paisjet nuk punojnë.

13. Te trashëgimia kulturore-historike, rindërtimi i kullës së veprimtarit të çështjes kombëtare dhe pajtimtarit “Ramadan Shabanit” në Kijevë . Kjo mund të bëhet dhe në bashkëpunim me

Ministrien e Kulturës, sepse kemi pasur kontakte mirëpo kërkojmë dhe përkrahjen e komunës. E kemi kullën e Tahir Rifat Berishës, Nexhmie Pagarushën, po t'i kishin komunat tjera këto asete të paktën i kishin trajtu me një mirësjellje më të mirë.

14. Stapanicë-rruga "Rahim Krasniqi" në gjatësi 800m, kanalizim 700m, trotuar 150m, ndërtimi i një fushe futbolli në shkollë e cila është paralelja e shkollës Kajtaz Ramadani.

15. Lubizhdë -rruga "Bahtjar Morina" 300m trotuar si dhe ndriqimi mungon.

16. Drenoc –rruga "Bujar Krasniqi" 600m asfalt si dhe ndriqimi mungon.

Ju lus të gjithëve si grupe pa dallime, në çoftëse i shihni që janë në interes të qytetarëve ju lus ta kemi përkrahjen e juaj. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Faleminderit i nderuar kryesues! I nderuar nënkryetar, të nderuar drejtor dhe të gjithë ju kolegë asambleisë!

I dëgjova kërkesat dhe shqetësimet e kolegëve asambleistë. Shqetësimi kryesor me këtë propozim të projekt buxhetit i lidhen me çështjen e bartjes së mjeteve nga vitet paraprake. Arsyeja pse disa projekte nuk janë realizuar është sepse ka qenë situatë pandemike këto dy vitet e fundit dhe shumicën e kohës vendi ynë ka qenë i izoluar dhe sa ka qenë i izoluar nuk kanë mundur me u realizu asnjë projekt. Një faktor tjetër pse është dashur me u bart mjetet është dhe fakti i kontrates kolektive dhe faktori i tretë është sepse janë futur projekte më shumë se sa kemi pasur mundësi buxhetore dhe sigurisht nuk kanë mundur me u realizu. Unë i dëgjova dhe kërkesat e kolegëve asambleistë, janë të nevojshme, mirëpo kërkesat dhe nevojat e qytetarëve janë shumë më të mëdhaja se sa mundësit buxhetore që ne i kemi. Ne si grup i asambleistëve të Nisma Socialdemokrat, e mbështesim projekt buxhetin e propozuar nga qeveria komunale. Këto kërkesa të opozitës dhe qeveria duhet t'i ketë parasysh që në të ardhmen, cila kërkesë është më e nevojshme ta fusim brenda buxhetit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Vetëm një pyetje kam, e cila ka të bëjë me një rrugë që nuk e pashë në projekt buxhet, një rrugë te Llapqeva te Ujvara e Mirushës. Ajo rrugë i është dhënë në vitin 2016 nëse nuk gaboj me memorandum me Ministrin e Infrastrukturës dhe ka mbetur shumë keq dhe është dëmtuar. Ajo rrugë nuk ju shërben vetëm banorëve të asaj anë, mirëpo e meriton me e zgjidh këtë kontekst, me u rregullu ajo rrugë, të bëhet me ndriqim dhe një pjese me trotuar sepse gjatë verës vizitohet prej shumë turistave.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Halil, unë pajtohem që buxheti duhet të jetë i ngarkuar prej këtyre projekteve të propozuara, mirëpo besoj se t'i duhet të pajtohesh se janë disa projekte shumë vitale, psh çerdhja në Drenoc. Unë propozoj dhe kam dëshirë që ai projekt të hudhet në votim, të jetë projekt dy vjeçar dhe domosdoshmërisht të hynë në projekt buxhet.

Argjend Thaçi: Urdhëro Veton!

Veton Zogaj: Halil, mandatin e kaluar nuk kam qenë asambleistë, mirëpo i kam përcjellur në vazhdimësi seancat dhe të paktën dy ose tri projekt buxhetet janë votuar me shumicën e antarëve të kuvendit. Ne si opozit pastaj dalim keq nëse nuk marrim pjesë në votim të paktën shumica. Ne dalim keq nëse ky buxhet votohet me 16 vota. Për me ndodh ky votim prej shumicës atëherë dhe ju duhet t'i keni parasysh që të përfshihen amandamentet tona si opozit. Nuk ka logjik nëse asnjë nga kërkesat tona nuk hynë në projekt buxhet.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Sigurisht që nuk jam kundër çerdhes në Drenovc, mirëpo dhe t'i e din që nuk kemi mjete financiare për momentin për me ndërtu çerdhe në Drenovc. Dhe t'i nuk besoj që je kundër një projekti që është aktualisht brenda projekt-buxhet që të hiqet dhe të vendoset çerdhja në Drenovc. Unë ju ftoj të gjithë juve që të votoni këtë projekt buxhet.

Argjend Thaçi: Udhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë! Te çështja e buxhetit që e përmendi Labinoti janë projekte që kemi projekte dy vjeçare dhe që janë të kontraktuara. Planifikimet e viteteve të kaluara kanë qenë mbi koston e buxhetit që e ka pasur të planifikuar komuna, për realizimin e tyre dhe tani jemi në pjesë të realizimit të të gjitha projekteve që janë të kontraktuara, që janë projekte dhe dy vjeçare. Te çështja e lapidarit që e përmendi Valoni është një gjë e planifikuar. Stadiumi është pjesë e kontratës dy vjeçare dhe është në realizim e sipër dhe do të realizohet që është e vitit të kaluar dhe e këtij viti. Kontrata kolektive është e pa mundur të planifikohet me buxhet komunal. U diskutua çështja e çerdheve, ne aktualisht në funksion e kemi një çerdhe dhe dy të tjera besoj se shumë shpejt do të hapen. Aktualisht kjo çerdhe dhe dy të tjerat kanë kapacitete të mjaftueshme për fazën e kërkesave që kanë qytetarët për t'i dërguar fëmijët e tyre aty. Por, nuk do të thotë se në një të ardhmen nuk është e nevojshme hapja e çerdheve të reja, siç është e planifikuar në buxhet të vitit 2023 që është e planifikuar në fshatin Bellanicë realizimi i një çerdhe. Çështja e rinovimit të shkollave dhe kthimi i tyre në çerdhe, ajo ka qenë kërkesë e mëhershme dhe kemi pasur premtim dhe nga Ministria e Arsimit, që do të realizohen disa shkolla të renovohen nga buxheti i tyre. U përmend shkolla e vjetër muze. Në buxhet është e planifikuar shkolla e mëhershme e Bajës të kthehet në muze.

Te çështja e rinovimit të rrugës "Ibrahim Mazreku" aty do të ketë ndërhyrje dhe në infrastrukturën e brendshme nëntoksore dhe në bashkëpunim me KEDS-in do të kemi dhe realizimin e infrastrukturës.

Te çështja e ngritjes së cilësisë në arsim. Ne si qeveri e kaluar nëpër shkolla kemi investuar mbi 400.000 € në pjesën e kabineteve, në aspektin e teknologjisë dhe në aspektin e kabneteve lëndore.

Te çështja e Malishevës urbane, ne kemi një në planifikim në buxhet dhe hartimin e projekteve për Malishevën urbane. Rregullimi i objektit të QKMF-së është e planifikuar. Te çështja e

investimeve kapitale ne e kemi një marrveshje me Bankën Botërore që janë disa objekte që do të investohet nga kjo Bank, siç është kuvendi komunal, gjimnazi “Hamdi Berisha”, shkolla e mesme profesionale në Kijevë, palestra sportive dhe shtëpia e kulturës.

Ne QKMF-ë do të ketë një renovim dhe pjesë e kësaj do të jetë dhe ashensori sepse është e planifikuar dhe ndërimi i kulmit të QKMF-së. Çështja e aparatit të laboratorit aktualisht është funksional laboratorit në QKMF-ë.

Rrethrrretullimi te gjamia në Dragobil, ajo rrugë është regjionale është pronë e Ministries së Infrastrukturës. Investimet në atë pjesë të rrugës duhet të kenë një kërkesë te Ministria që të intervenoj. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: 60% të projekteve janë të bartura. Në fillim është dashur të na thoni që nuk ka mundësi me i vendos këto projekte në buxhet dhe ne e kishim përfunduar këtë punë. Votat i keni dhe ju e dini si i keni bërë. Pa marr parasysh a kalojnë propozimet, unë kisha kërkuar që secili propozim të votohet veq e veq dhe le ta shohin qytetarët qasjen e juaj.

Argjend Thaçi: Urdhëro, nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Faleminderit, kryesues! Fillimisht më lejoni të ju uroj mandatin 4 vjeçar si këshilltar të asambles komunale në kuvendin e Malishevës!

Sot nga gjithë ju të pranishmit u diskutua për projekt-buxhetin për vitin 2022-2024 dhe secili pasqyroi interesat e qytetarëve të komunës së Malishevës. Të gjithë ju, së bashku me ne, e dimë mirë që mundësit buxhetore janë të vogla që të përfshihen të gjitha kërkesat. Ne e kemi trashëguar, i ka kry të gjitha procedurat ligjore, dëgjimet publike dhe i njejtë nuk është miratuar. Ministria ka kërkuar që të kthehet tek Komiteti për Politikë dhe Financa i sapo zgjedhur tashmë dhe në atë rast sigurisht që i kemi bërë disa lëvizje të projekt buxhetit dhe për shkak të kohës që ne si komunë e Malishevës jemi vonuar në miratimin e buxhetit, sigurisht që nuk kemi inicuar procedura të ankesës të MAPL-ja. Po kërkoj nga ju që të keni mirkuptimin tonë, sepse jemi në një fazë urgjente të miratimit të buxhetit. Ne si ekzekutiv ju garantoj se në projekt buxhetet e viteve të ardhshme do të jem shumë konstruktive në këtë aspekt dhe bashkë me ju do t'i vendosim nga viti në vit dhe gjithë së bashku ta nxjerrim një buxhet i cili është gjithëpërfshirës për qytetarët e Malishevës.

Komuna e Malishevës nuk ka borgj 60%, nuk janë projekte të bartura 60%. Komuna e Malishevës nuk e ka asnjë borgj, sepse borgj llogaritet kur t'i nuk ke mundur me i kry fakturat ose obligimet të cilat janë të faktume nga viti i kaluar. Kemi projekte të bartura. Pse kemi projekte të bartura? Projekti i vitit 2021 ka qenë i stëngarkuar me propozim të projekteve. Te rrugët kemi vendosur emrat e fshatrave pa e llogaritur koston apo metrat të cilat janë vendosur në ato fshatra. Njejtë është vazhduar dhe me kanalizime dhe me trotuar. Në këtë mënyrë projektet e vitit 2020 janë bartur në vitin 2021. Ne do të mundohemi të përmirsohemi në këtë aspekt por me bashkëpunimin e juaj, sepse të gjitha propozimet e juaja janë të nevojshme mirëpo mundësit buxhetore nuk na mundësojnë këtë gjë. Nese ne i vendosim të gjitha këto dhe i votojm sigurisht

që kemi me pas të njëjtin rast bartje në vitin tjetër. Ju ftoj të gjithëve të keni mirëkuptim, siç do të kemi mirëkuptim dhe ne ndaj jush në projekt buxhetet e viteve të ardhshme do t'i përpilojmë së bashku.

U përmend hartimi i projektit- pa pasur hartim të projektit ne nuk mundemi me inicu procedurë të prokurimit pastaj. Ne jemi në përfundim të hartimit të projekteve ose detyrave projektuese dhe shumë shpejt do ta kemi në ftes publike, ku do të aplikojnë projektet brenda dhe jashtë për hartimin e projektit të Malishevës urbane. Disa projekte i kemi paraparë dhe në pjesën e dytë të vitit të fillojmë, sidomos te sheshi në rrugën "Rilindja Kombëtare: tani "Ibrahim Mazreku".
Faleminderit nga ju!

Argjend Thaçi: Urdhëro Arlind!

Arlind Morina: Faleminderit, kryesues! Përsëritet për të gjithë!

Unë do ndërlihem me këtë pikë të rendit të ditës. Dhe ne kemi pasur kërkesa që të futen në projekt-buxhet, mirëpo meqë jemi vonuar në miraimin e këti buxheti, ne nuk kemi dashur të prishim projekte të tjera që janë në buxhet dhe t'i fusim projektet tona. Sa e kam shfletuar buxhetin e kam parë që shumë fshatra janë të përfshira në këtë projekt buxhet. Unë kërkoj që ky buxhet të mbështetet.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Nënkyetar, të paktën tre mandate ke qenë Drejtor i Financave, ajo çka ka ndodhur me buxhetin e kësaj radhe, është hera parë që po i ndodhë komunës së Malishevës. Nëse do ishin dëgjuar vërejtjet e opozitës, sot nuk do ishim duke e debatuar buxhetin. Ne kemi kërkuar atë ditë që seanca të shtyhet të paktën për 3 ditë, që të kemi mundësi të shfletojmë këtë projekt-buxhet, mirëpo nuk keni dashur. Kjo vones nuk ka ardhur si shkak i opozitës por për shkak të pozitës. Asambleja që ka qenë me 30 shtator e ka afatin ligjor dhe është dashur ta votoj buxhetin, jo të na sjellin neve në situatë të tillë. Gabimi aty ka nis dhe ju e keni vazhduar me kryeneqësi të numrave.

Argjend Thaçi: Urdhëro Nebih!

Nebih Bibaj: Projekt-buxhetet e kaluara janë votuar prej shumicës së asambleistëve. Nu e di kush e merr fajin, ata që e projektojnë apo ata që e votojnë këtë projekt buxhet. Ne kemi qenë projektues të projekt-buxheteve bashkë me ekzekutivin, unë nuk e kuptoj pse është vonuar realizimi i tyre. Unë dhe më herët e thash ka qenë rrugë 200m, nuk është shtrur, kjo ka një qëllim ka një tendenc. Trotuari 600m tre herë është përsëritur, nuk është realizu.

Argjend Thaçi: Urdhëro Burim!

Burim Paqarizi: Përsëritet për të gjithë!

Te ky projekti i rrethrroutullimit, e di që duhet me ba kërkesë tek Ministria përkatëse, për shkak se është rrugë regjionale, mirëpo për fshatin Dragobil është shumë i nevojshëm sepse është shumë

e rrezikshe për banorët e fshatit Dragobil. Unë kisha kërkuar që të inicohen procedurat, të shkojmë të bëjmë kërkesë në Ministri të Infrastrukturës dhe të marrim leje për realizimin e këtij projekti dhe të bëjmë një zgjidhje të mirë për fshatin Dragobil.

Argjend Thaçi: Urdhëro, nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Ajo çka mbetet e jona është që drejtori me një kërkesë, me një arsyeshmëri shumë të qëndrueshme t'i drejtorohemi Ministries së Infrastrukturës, por jo dhe ta fusim në buxhet sepse është rrugë regjionale. Nebih e përmende që ka shumë vonesa në ekzekutim të buxhetit është e vërtetë sepse ka pasur vonesa sidomos në vitin e kaluar. Unë me përgjegjësi të plot e them që do të jeni pjesë e përpilimit të buxhetit, nga fillimi ku do të starton qarkorja e parë në prill për vitin 2023 dhe do të jemi bashkëpërpilues të buxhetit. Kërkojë mirëkuptim për këtë projekt-buxhet, sepse jemi vonë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Mbi bazën e asaj praktike që kemi pasur në kuadër të Ministries së Financave për çështjen e ndarjes, çfarë forme kanë bërë ata betohem vetëm nëse e kanë bërë në formë të jashtëligjshme, megjithëse kam informacion se Drenasi nuk ka mundur, sepse i ka mbi 4.000.000€ borgie. Pasqyrat financiare shumë shpejt do t'i shihni për shpenzimet dhe obligimet që ka pasur gjatë vitit 2021.

Argjend Thaçi: Shkojmë në votim, për shfuqizimin e vendimit të MAPL-së nr.02/04 datë: 10.01.2022 për miratimin e buxhetit të komunës së Malishevës për vitin 2022-2024, me theks të veçantë për vitin 2022, sipas kërkesës 020-20/1 të datës: 17.01.2020. Kush është për shfuqizimin e këtij vendimi?

Për: 30

Kundër: 0

Abstenim: 0

Votohet propozimi i Valon Krasniqit për ndërtimin e Lapidarit të Dëshmorit të Kombit "Afrim Krasniqi" në fshatin Bardhë, në vlerë 25.000€ . Kush është për?

Për: 29

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 29 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, ky propozim i bashkangjitet projekt buxhetit të propozuar nga kryetari.

Shkojmë në votim për propozimet e Valon Krasniqit për infrastrukturën. Kush është për?

Për: 14

Kundër: 14

Abstenim: 2

Kryesuesi ka votën e dyfishtë dhe vota është kundër. Me 15 vota për propozimet e Valon Krasniqit për infrastrukturën nuk kalojnë.

Votohen propozimet e antarit të PDK-së Alban Kastratit. Kush është për?

Për: 14

Kundër: 15

Abstenim: 1

Me 14 vota për, 15 kundër dhe 1 abstenim, propozime nga grupi PDK-së nuk kalojnë.

Votohen propozimet e antarit të VV-së Veton Zogaj?

Për: 14

Kundër: 16

Abstenim: 0

Me 14 vota për, 16 kundër, propozimet nga VV-ja nuk kalojnë.

Votohen propozimet e antarit të LDK-së Labinot Gashi. Kush është për?

Për: 14

Kundër: 15

Abstenim: 1

Sallën lëshojnë grupi nga PDK, antarët nga VV-ja Veton Zogaj dhe Arbnore Hoti, antarët nga LDK-ja Labinot Gashi, Zamir Morina, Adile Hoxha.

Prezent në sallë janë 17 asambleistë. Propozimi i Valon Krasniqit për ndërtimin e lapidarit "Afrim Krasniqit" në Bardhë i bashkangjitet projekt-buxhetit.


Shkojmë në votim për projekt-buxhetin e propozuar nga Kryetari i Komunës. Kush është për?

Për: 17

Me 17 vota për, miratohet projekt buxheti i propozuar nga kryetari i komunës. Urime të gjithëve! Këtë seancë e shpalli të mbyllur.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

